



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Rruga Naim Frashëri Nr 37, Tiranë , ALBANIA

PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR EFEKT MARRJEN E SHKALLËVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE TË CIKLIT FILLOR

1. HYRJE

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të ciklit fillor është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit-IZHA. Ai u vjen në ndihmë të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve si dhe të gjithë mësuesve të ciklit fillor për t'u përgatitur për testimin kombëtar për marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që MASH-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve:

- dokumentet zyrtare¹ të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore – edukative të mësuesve,
- programet përkatëse lëndore,
- aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënien e ciklit fillor
- përmbajtjen shkencore të lëndëve të ciklit fillor, nga klasa 1-5

2. QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të ciklit fillor është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin e tyre profesional. Programi është hartuar nga grupi i punës duke mbajtur parasysh përmbushjen e dy qëllimeve kryesore:

- *Së pari*, ofrohet si një program orientues për Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat e Arsimit si dhe të gjithë mësuesve të ciklit fillor në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese në

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASH që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

bazë rrethi. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DAR/ZA-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete.

- *Së dyti*, ai është një program i detyruar veçanërisht për mësuesit që këtë vit do të marrin kualifikimin 5, 10 dhe 20 vjeçar, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje gjithëvjete për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar.

Programi synon:

- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor, e, në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore.
- Rritjen e aftësive dhe të kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor, drejt një mësimdhënieje të suksesshme.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim.
- Realizimin në praktikë nëpërmjet demonstrimit konkret të aftësive të fituara, e në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të ciklit fillor është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër, për të cilat testohen mësuesit. Për secilën fushë janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i ciklit fillor që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit.

Programi është ndërtuar duke pasur si pikënisje standardet bazë të përgjithshme të mësuesit si dhe standardet e mësuesit të ciklit fillor. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhen me secilën fushë të testimit do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë nevojat e tij si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat që mësuesit duhet të zotërojnë në fushën e njohurive dhe aftësive si dhe literatura përkatëse rekomanduese që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Fusha: Dokumentet zyrtare

Kjo fushë synon që mësuesi i ciklit fillor:

- të jetë njohës i mirë i kërkesave të dokumentacionit shkollor, të shtruara në Ligjin për Sistemin arsimor parauniversitar, Dispozitat normative dhe në Udhëzimet e nxjerra nga MASH.
- t'i interpretojë dokumentet kryesore politike të reformës arsimore të arsimit parauniversitar në situata konkrete, të praktikave të përditshme.

Rezultati	Literatura
Mësuesi duhet të jetë i aftë:	
<ul style="list-style-type: none"> • të njohë dhe të zbatojë Ligjin për arsimin parauniversitar. • të interpretojë dokumentet kryesore politike të reformës arsimore të dala gjatë këtyre viteve të fundit. • të ketë njohuri rreth kërkesave të dokumentacionit shkollor, të shtruara në Ligjin për Sistemin arsimor parauniversitar, Dispozitat normative dhe në Udhëzimet e nxjerra nga MASH. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” ndryshuar me ligjin nr.8387, datë 30.7.1998 për disa ndryshime ne ligjin nr.7952, date 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar". • Dispozitat Normative për arsimin parauniversitar (DN). <ul style="list-style-type: none"> - Të drejtat e nxënësve (Neni 21) - Qeveria e nxënësve (Neni 37) - Mësuesi, të drejtat e detyrat (Nenet 43, 44, 45) - Organet kolegjiale në shkollë (Nenet 51, 53, 54) - Udhëzimi Nr.29, dt 25.09.2007 i MASH ”Për grumbullimin, ruajtjen dhe përdorimin e të ardhurave nga dhurimet, nga prindërit e nxënësve të shkollave të Arsimit Parauniversitar”. • Udhëzimi Nr. 37, dt.09.10.2007 i MASH “Për paraqitjen e personelit të shkollës në mjediset shkollore” • Udhëzimi Nr.40, dt 17.10.2007 i MASH ”Për ngritjen e funksionimin e bordit të shkollës”. • Punimi i Udhëzimit të MASH Nr. 17, datë 29.06.2010 “Për strukturën dhe planet mësimore në Arsimin Parauniversitar për vitin shkollor 2010-2011”. • Punimi i Udhëzimit Nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e Arsimit Parauniversitar”. • Punimi i Udhëzimit të MASH, Nr. 26 datë

	<p>10.08.2010 “Për mbarëvajtjen e punës mësimore edukative në sistemin e Arsimit Parauniversitar në vitin shkollor 2010-2011.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzimi i Alterteksit 2010-2011 • “Kualifikimi i mësuesve – Teste” 2008, 2009 2010
<p>Fusha: Programet lëndore</p> <p>Kjo fushë synon që mësuesi i ciklit fillor:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të reflektojë ndaj vizionit kurrikular të arsimit fillor. • të interpretojë dhe të punojë mbi standardet e përmbajtjes dhe të arritjes. • të kuptojë dhe të planifikojë sipas kërkesave të programeve lëndore • të njohë dhe të përdorë instrumente të ndryshme vlerësimi për arritjet e nxënësve. 	
<p>Rezultati Mësuesi duhet të jetë i aftë:</p>	<p>Literatura</p>
<ul style="list-style-type: none"> • të qëndrojë në korrent të të reja të përmbajtjes shkencore të arsimit fillor. • të njohë dhe të zbatojë: <ul style="list-style-type: none"> - parimet, - synimet, - objektivat e përgjithshme dhe specifike, - fushat e studimit, - integrimin ndërlëndor, - metodikën e zbatimit, - vlerësimin e programeve lëndore në arsimin fillor . • të planifikojë projekte kurrikulare dhe module mësimore për orët e lira. • të planifikojë në mënyrë sa më efektive veprimtaritë ekstrakurrikulare. • të ndërtojë një test lëndor dhe të organizojë miniteste në orën e mësimit. • të vlerësojë dhe të masë në mënyrë sistematike progresin e nxënësve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Standardet e përmbajtjes dhe të arritjes në lëndët e ciklit fillor, ISP 2002, 2003. • Programet lëndore për klasat I, II, III, IV, V. • Revistat pedagogjike • Buletinet “Kurrikula dhe shkolla”, ISP, IKS, QTKA • Udhëzimi Nr. 49, dt. 27.12.2006 i MASH "Për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve". • Udhëzimi Nr.38 , dt.09.10.2007 i MASH "Për zhvillimin e orëve të lira në shkollë". • Udhëzimi Nr. 35, dt.09.10.2007 i MASH “Për lirinë e mësuesit për orët mësimore të parashikuara në programin lëndor” • “Veprimtari ekstrakurrikulare” klasa I- XII, IKS, 2005. • “Të drejtat e njeriut dhe demokracia në veprim -Veprimtari kros dhe ekstrakurrikulare, 2007. • “Si t’i hartojmë objektivat e arritjeve të nxënësve”, Cikli fillor, IKT 2008. • Shembuj projektsh kurrikulare të dhëna nga IKT, në seminarin kombëtar për kurrikulat e reja V, IX - gusht 2008. • Manulai i drejtimit të shkollës, IKT, 2008

Fusha: Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie

Nëpërmjet kësaj fushe synohet që mësuesi i ciklit fillor:

- të jetë njohës i mirë i aspekteve psikologjike, didaktike dhe pedagogjike të mësimdhënies, i stileve të të nxënësve dhe i psikologjisë moshore të nxënësve me të cilët punon.
- të njihet me literaturën pedagogjike në ndihmë të mësimdhënies efektive, ndërvepruese dhe bashkëkohore.
- të zbatojë në praktikën e përditshme të mësimdhënies metoda dhe strategji ndërvepruese.

Rezultati	Literatura ²
<p>Mësuesi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të punojë për përmbushjen e karakteristikave të shkollës efektive. • të krijojë një mjedis nxitës dhe efektiv pune. • të njohë dhe të veprojë sipas veçorive psiko-pedagogjike të kësaj moshe shkollore (6-11 vjeç). • të analizojë elementet që i bashkojnë dhe i dallojnë tipet e mësimdhënies me njëra-tjetrën. • të menaxhojë situata, sjellje dhe veprime të ndryshme nxënësish. • të njohë rolin dhe shprehjet profesionale që i duhen mësuesit të ciklit fillor. • ta ndërtojë mësimdhënien sipas objektivave të arritjes. • t'i motivojë nxënësit në forma e mënyra efektive. • t'i zbatojë metodat e mësimdhënies në përshtatje me lëndën, temën e mësimit dhe me moshën e nxënësve. • të planifikojë veprimtari që nxisin të menduarit kritik e krijues të nxënësve. • të zhvillojë mësimdhënie të diferencuar. • të dallojë vështirësinë në të nxënë nga aftësia e kufizuar. 	<ul style="list-style-type: none"> • “Mësimdhënia me në qendër nxënësin” (I), QTKA, dhjetor 2005. • “Metodologji e mësimdhënies”, B.Musai, Tiranë 2003 • “Mësimdhënia dhe të nxënësit”, A.Tamo, E.Rapti, Th.Karaj, Mokra, 2005 • “Hyrje në mësimdhënien e diferencuar”, Prof.as.dr.P. Muka, Dh. Karaj, L. Çela, QTKA 2006 • Për zhvillimin profesional “Ndërveprimi në klasë” - Cikli fillor, ISP 2003 • Buletinet “Aspekte psiko-pedagogjike”, ISP • Buletinet “Kurrikula dhe shkolla” cikli fillor, ISP • Mendja e disiplinuar”, Gardner, ISP. • “Studio gjithshka, arsyes vendin e parë” AEDP • “Shkolla e të nxënësve” Gardner, ISP. • Hartimi i objektivave të arritjes për një kapitull (linjë), IKT, 2007. • “Të mësuarit me objektiva & Modeli A-94” Eureka 95 P.Muka • “Objektivat minimalë të domosdoshëm”, S.Llambiri • “Strategjitë e të mësuarit” Eureka 1995.

² Mësuesi mund të shfrytëzojë botime të ndryshme që gjenden në bibliotekë, të botuara nga organizata të ndryshme që veprojnë në fushën e edukimit ose në librari, konform kërkesave të kësaj fushe.

<ul style="list-style-type: none"> të hartojë plane edukative individuale. të përdorë mënyra të ndryshme të vlerësimit të nxënësve. 	<ul style="list-style-type: none"> Materiale burimore të përdorura në seminarët e zhvilluara nga programi i edukimit - “Save the children” për gjithëpërfshirjen.
<p>Fusha: Përmbajtja shkencore e lëndëve të ciklit fillor</p> <p>Nëpërmjet kësaj fushe synohet që mësuesi i ciklit fillor:</p> <ul style="list-style-type: none"> të zotërojë të gjitha programet lëndore nga klasa I-V; njohuritë, aftësitë dhe shprehjet kryesore që duhet t’u transmetojë nxënësve të ciklit fillor. t’u transmetojë saktë nxënësve njohuritë e dhëna në tekstet shkollore, konform programeve lëndore, nga klasa I – V. 	
<p>Rezultati Mësuesi duhet të jetë i aftë:</p>	<p>Literatura³</p>
<ul style="list-style-type: none"> të zotërojë konceptet shkencore, dukuritë, ligjësitë në nivel shkencor dhe didaktik. t’i transmetojë konceptet shkencore, dukuritë, ligjësitë dhe rregullat në përshtatje me moshën dhe të nxënë të nxënësve të zotërojë njohuritë, aftësitë dhe shprehjet që fitojnë nxënësit nga klasa I-V për çdo program lëndor. të njohë dhe të planifikojë sipas vështirësive tipike që hasin nxënësit gjatë procesit mësimor. t’ua përshtasë programet lëndore nxënësve që paraqesin vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuar. 	<ul style="list-style-type: none"> Programi i gjuhës shqipe nga klasa I-V Programi i matematikës, nga klasa I-V Programi i edukimit figurativ nga klasa I-V Programi i edukimit muzikor nga klasa I-V Programi i edukimit fizik nga klasa I-V Programi i diturisë së natyrës klasa III- IV- V Programi i historisë së Shqipërisë, klasa IV Programi i Vendlindjes klasa V Tekstet shkollore Botime të ndryshme për nxënësit e ciklit fillor Tekstet në ndihmë të mësuesit

³ Mësuesi mund të shfrytëzojë botime të ndryshme që gjenden në bibliotekë, të botuara nga organizata të ndryshme që veprojnë në fushën e edukimit ose në librari, konform kërkesave të kësaj fushe.